

INTERVISTË ME FADIL SOFTËN

Prizren | Data: 18 gusht, 2018

Kohëzgjatja | 63 minuta

Të pranishëm:

- Fadil Softa (I intervistuari)
- Edi Gashi (Intervistuesi)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Atëherë a mundeni me prezantu veten, me na tregu diçka për kujtimet e hershme të fëmijësisë, në çfarë vendi jeni lindë, në çfarë familje jeni rritë?

Fadil Softa: Po, si jo. Quhem Fadil Softa prej familjes Softa, numri në familje ka qenë pesë vetë, dy motra edhe edhe, edhe tre mashkuj. Të gjithë kemi qenë të shkollum. Shkollën e ultë e kemi kry në Prizren, shkollën e mesme në Prizren. Nji vjet kam studiu në Novi Sad, në Fakultetin e Teknologjisë, por mandej rastet financiare ka qenë asi problem. Jemi kthy, jam kthy në Prishtinë, ashtu që në Prishtinë në 70-shin diplomova. Jam kimist i diplomuar. Mandej pas ushtrisë, jam inkuadru në “Farmakos”.

Aurela Kadriu: A na tregon çfarë familje ka qenë kjo e juja, ma s’pari në cilin vit jeni lindë edhe...

Fadil Softa: Unë jam i lindur 1944-shit, domethanë tash i kam 74-75 vjet, po ende jam aktiv asi në suazat e... po mendoj, në profesionin tem, ende nuk jom ndalë. Nëqoftëse nuk muj këtu me gjetë asi, me zgjidhë probleme, atëherë duhet me vazhdu pak jashta Kosovës. Por i kemi bisedat me afru teknologjinë e grumbullimit, disa preparatave që e kemi pasë, por ma së tepërmi në prodhimet prej bimëve mjekësore, se Kosova asht’ e pasunuar me bimët mjekësore. Përafërsisht ka 1600 lloje, 600 nënllloje bimësh që mundemi me përdorë për, për kryerjen e preparateve të ndryshme për shërimin e popullit. Kështu që, a ju intereson diçka tjetër?

Aurela Kadriu: Po, po veç kisha dashtë, kemi me folë edhe për jetën profesionale se është e randësishme, por po kem qef pak me u ndalë edhe te jeta juaj familjare. Si fëmijë, jeni lindë në një kohë goxha specifike.

Fadil Softa: Po, ‘44-shin.

Aurela Kadriu: Moment historik...

Fadil Softa: Po, ashtu.

Aurela Kadriu: Kisha pasë qef me ditë fëmijënia juj në Prizren qysh ka qenë n’atë kohë, me çka janë marrë prindërit e juj, çfarë familje keni qenë?

Fadil Softa: Baba, ka pasë qenë Muharrem Softa, po. Nana ka qenë, asi shtëpiake me profesion. Por, baba ka qenë intelektual, ka qenë drejtor i firmës “Bora” e atëhershit. Është marrë me materiale për ndërtimtari.

Edi Gashi: Në Prizren?

Fadil Softa: Po, në Prizren, edhe ai ka qenë adhures, gjithmonë na ka preferu të angazhohemi me krye asi fakultetin edhe shkollën, edhe të gjithë kemi [kry] prej familjes, dy motra, tri vëllazën. I ndjeri Fatmir Softa, ai ka qenë drejtor i një repartit “Famipës” ai vdiq para disa, ‘96-shit ka vdekë.

Edi Gashi: Vëllau?

Fadil Softa: Po, vëllau. Ai ka qenë ekspert për elektrokontakte, për këto sendet. Ka specializu në Francë, mandej osht’ kthy këtu. Ka pasë, ka formu “Famipën”. “Famipa” tash osht’ zhdukur, osht’ rrafshu asi me tokë, qysh m’i thonë. Ashtu që unë, pasiqë e kryva fakultetin u inkuadrova në “Farmakos”. Në vitin ‘72, intelektualisht kam qenë i angazhum shumë, posaçërisht atëherë na serbisht kemi pasë asi ligjeratat në Fakultetin e Kimisë. E ma tepër kemi pasë profesorë prej Beogradit, ma pak prej Prishtinës. Ashtu që kam arritë me diplomu me suksesin shembullor. Mandej kur u inkuadrova në “Farmakos”, sërbi ka qenë drejtor, i vetmi shqiptar unë kam qenë prej intelektualëve.

Kam fillu, unë kam do fotografi, do t’jua afroju juve, nëqoftëse ju intereson. Kam zhvillu laboratoriumin, kam zhvillu laboratoriumin për përcjelljen e kualitetit të prodhimeve interne në “Farmakos” edhe krejt kam arritë ato punët me kry. Edhe ashtu deri ‘92-shin kam qenë në “Farmakos”, mandej pasi që u privatizu kemi qenë të largumë. E mandej ma vonë duhet me tregu çka kam ba, mandej ma vonë kam ble unë “Farmakosin”, mandej nuk ka nevojë tash me u ndalë aty, këto janë.

Aurela Kadriu: Në shkollë fillore ku keni shku?

Fadil Softa: Në Prizren.

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë, a keni naj kujtim prej shkollës fillore, a e mbani në mend?

Fadil Softa: Ka, ka sigurisht.

Aurela Kadriu: Çfarë kohe ka qenë për juve?

Fadil Softa: Unë nuk kam qenë i urtë, a din? (qeshë) Por kam kry shkollën e ultë “Bajram Curri” edhe aty probleme kam pasë të ndryshme, drejtori ka pasë probleme me ne. Dy vjet kemi qenë që me të vërtetë, kemi qenë të diplomum, por si me thonë, profesortë asi, mësusit nuk kanë qenë, asi, nuk ka qenë i kënaqun me ne.

Edi Gashi: Pse?

Fadil Softa: Pse... tash nuk ka nevojë me tregu çka kam bërë asi (qeshë). Nji send, për shembull atëherë ka qenë dinari prej alluminiumit. Na bojshim, bojshim asi ato fishekët edhe pak me gojë asi e

zbutshim edhe i gjujshim në tavan. E kështu, kemi pasë asi, edhe kur m'i kanë thirrë prindit, “Ejani m'i pa për shembull çka asht' tu bo Fadili”. Nana vjen, thotë, “Zotëri”, Isa ka qenë emri i tij, “çka ka bo djali im?” Tha, “Zojë, kqyre në tavan çka ka bo” (qeshë). E qaty ka qenë shumë interesant. E kështu, e në të vërtetë...

Edi Gashi: Shkollën e mesme në Prizren e keni kry apo?

Fadil Softa: Të mesme në Prizren e kam kry, në Prizren. Në gjimnazin e Prizrenit, aty kam shku '64-shin kam kry. Mandej '64-shit kam shku, '65 në Novi Sad, një vjet kam qenë aty, pasi që...

Aurela Kadriu: Ketë t'u tregu edhe një ngjarje prej shkollës fillore apo më duket...

Fadil Softa: E tash mos m'qitni me tregu se nuk asi sene tjera... (qeshë)

Aurela Kadriu: S'ka lidhje, ato janë interesante për neve, vetëm nëse ju nuk doni, kështu personalisht.

Fadil Softa: Këto janë sendet asi shumë interesante, çdokush i ka ato, atë historinë e vet asi. Nashta kam pasë superenergji, a din, superenergji. Nuk kam mujt me nejt me një vend ashtu që (qeshë), edhe mirë kam kalu.

Aurela Kadriu: E sa i përket jetës shoqnore, po mendoj në shkollë...

Fadil Softa: Në gjimnaz kam qenë shumë aktiv. Bile, bile kam qenë kryetari për organizimin e klubit foto, domethanë kemi pasë fotoaparate. Kam pasë një aparat, kështu fotoaparati, 70 poza ka asi, 70, domethanë gjysën ka rrok, gjysën, po 36-tën normalisht a, 36 e 72 foto kemi nxjerr prej asaj. Edhe e kam pasë shoku im Besim Nallbani edhe ai ka qenë i interesum. Në asi kabinet kemi punu shumë, kemi ndihmu nxansëve, kemi dhanë fotografitë edhe atëherëshëm.

Aurela Kadriu: A i zhvillojshit fotografitë?

Fadil Softa: Po, po, po, po.

Aurela Kadriu: A ka qenë kjo njëfarë afiniteti?

Fadil Softa: Afinitet, po. Aktivitet i lirë kemi pasë, por edhe drejtori i shkollës ka leju a din. Ka pa që na jemi aktivë në këtë drejtim edhe na kanë leju me punu. Kemi punu edhe kemi aktivizu tjetër që me pasë fotoaparatin, me pasë atë aparat për kopjimin e fotografive. E shumë rrallë njerëzit e kanë pasë atëherë.

Aurela Kadriu: Jo po du me thanë, kur i zhvillojshit fotografitë, a e keni pasë atë procesin kimik, a e keni vërejtë aty afinitetin për kimi?

Fadil Softa: Po, po, po. Kemi, fiksirin¹ kemi organizu, kemi organizu edhe se e kemi bo fiksirin. Mandej edhe atë tjetrin, harrova tash emrat e atyne substancave, asi tretjeve. Por nuk ka qenë asi problem për ne, se financimin ka bo shkolla, domethanë krejt materialet që asht; dashtë me përdorë asi për fiksir, për aktivitetin e këtyne fotografëve, harrova emrat e fiksirit, po edhe një tjetër ka qenë.

Aurela Kadriu: E qysh u bojke ai procesi i zhvillimit të fotografisë, a na tregon?

Fadil Softa: Shumë bukur, shumë bukur. Kam fotografi, se s'e morra, nuk mendojsha që do të bëni pyetje në këtë drejtim, se kam pasë një aparat shumë interesant për kopjimin e asi... po shkolla ka ble ato.

Aurela Kadriu: Po mendoj fazat e procesit të zhvillimit të fotografive, bash po m'intereson me ditë qysh ka qenë?

Fadil Softa: Po ka qenë së pari, negativa ka qenë, po ashtu negativin kam asi, kemi shtu në *razređivač* serbisht, shqip nuk po di qysh asi.

Aurela Kadriu: Tretës a?

Fadil Softa: Tretëse, po. Mandej në fiksir kemi fut, u zhvillu fotografia edhe kemi, në tela kemi asi, e kemi terë atë normalisht.

Edi Gashi: A ka ekzistuar laborator?

Fadil Softa: Po, po, në laborator, laborator në atë kohë ka qenë. Unë kam një fotografi, por nëqoftëse je interesime, unë muj me dhanë kopjen e asaj. Se nuk e mora, nuk mendojsha që do t'bëhet pyetja në këtë drejtim.

Aurela Kadriu: Qysh e ka pasë emrin gjimnazi?

Fadil Softa: Emrin ka pasë, gjimnazi sërë ka qenë ajo, emrin e ka pasë sërë. Harrova emrin pasha Zotin.

Aurela Kadriu: S'ka problem. E a mësojshin në gjuhën serbe, a mësojshin shqip në gjimnaz?

Fadil Softa: Në gjimnaz serbisht na kemi qenë.

Aurela Kadriu: Po.

Fadil Softa: Po, serbisht edhe turqisht. Edhe turqisht ka pasë.

Aurela Kadriu: Ah, edhe turqisht. A ka najfarë prejardhje turke familja juaj?

¹ Fiksuesi fotografik është një përzjerje e kimikateve të përdorura në hapin përfundimtar në përpunimin fotografik të filmit ose letrës.

Fadil Softa: Jo, jo, shiptarë. Po ashtu ka qenë ajo periudha politike, siç thashë une parës. Nuk du politikë me hy asi... se atëherë ka qenë... mos shënoni këto sendet a. A bon a? Qeto mos e... po du me tregu çka ka qenë ajo gjenerata e atëhershëm.

Edi Gashi: Për vitet '50, '60, a mundemi me folë për politikën?

Fadil Softa: Ka qenë politika e asi soji ka hap paralele turke për me i turqizu shiptarët edhe me i çu në asi, me i orientu kah Turqia. Ajo ka qenë një politikë destruktive se atëhere edhe Turqia ka pasë, ka bo gabimet edhe asi... këta tanët, Serbia ka qenë atëherë, Jugosllavia ku osht'. Edhe shkollën asi, shkollën e mesme kemi kry gjysë-gjysë, por fakultetin kemi kry edhe në gjuhën serbe. Vetëm një send osht' aty, se e kam pasë një konsideratë ndaj profesorëve. Nuk kanë qenë, asi [paragjykues], real kanë qenë kur kanë, notat kur kanë vlerësu.

Edi Gashi: Nuk kanë bo dallime.

Fadil Softa: Jo. Jo, jo edhe na kemi bërë asi punimet, diplomën kur kemi punu, asi... Bile, bile kemi gjetë një send shumë ma mirë se që asht' në literaturë edhe ata kanë qenë të kënaqur. Mandej qat materialin kanë marrë unë kam pasë përcaktimin në muriblenit, në ato tretjet ma e reaguara edhe kam arritë me bo rezultatet të mdhaja. Edhe ata kanë marrë kanë doktoru me to. Une kom diplomu, ata kanë doktoru.

Aurela Kadriu: E qysh vendosët... po?

Fadil Softa: Ka qenë një bullgar, njëfarë Angelligo. Mandej njëfarë Stefanoviçi ka qenë asi prej Beogradi edhe Tihomiri ka qenë prej Beogradit. Domethanë, ata shumë real kanë qenë. Nuk muj me thanë që hakun kanë hangër. E kështu.

Aurela Kadriu: Qysh vendosët me studiu kimi, ka ju erdh...?

Fadil Softa: Eh, qysh! E tash shumë interesant asht' ajo, një pyetje e bukur. Kam pasë Radmilla Rexhepagiq, ajo ka qenë myslimane, kimiste. Ajo kur spjegojke asi ato bashkëdyzimet, molekulat strukturale, disi nuk ka pasë nevojë unë me mësu asi në shpi, por në mësim aty direkt kam marrë aq fortë edhe aq mirë kam dëgju asi ligjerata, saqë kurrë shpi nuk kam lexu ato. Edhe gjithmonë kam pasë pesëshe.

Edi Gashi: A ka qenë ajo arsimtare në gjimnaz?

Fadil Softa: Në gjimnaz, Radmilla Rexhepagiq osht', edhe po mendoj grupi jonë me të vërtetë ka kry shumë suksese. Krejt janë asi në shkolla të larta, me fakultete, me magjistraturën kanë kry. Fizikën, kiminë kanë kry. Unë në kimi jam orientu se babai thoshte kështu, thojke, "Merre një fakultet që osht' edhe fakultet edhe zanat". Por e morra bash qato, por zanat asht' për mu se unë jam marrë me ma tepër me farmaci, pse kimia edhe farmacia shkon përbashkët, kështu paralelisht shkojnë. Edhe kur u inkuadrova në "Farmakos", atëherë shumë ma tepër kam marrë, jam marrë me teknologji, përpunimin e barnave edhe shumë lloje barnash kemi prodhu, për afërsisht njëqind lloje. Unë kam pru do, që ju

nevojitet asi, njëqind lloje barnash, por kemi pasë ndihmë prej doktor Kajfeshit prej Zagrebit. Ai ka qenë... Mos po don diçka zojë? [i drejtohet intervistueses]

Aurela Kadriu: Jo, jo, vazhdoni, vazhdoni.

Fadil Softa: Doktor Kajfeshi, ai ka qenë doktor i shkencave për farmaci. Ai ka formu asi “Krka” në Novo Mesto, mandej edhe “Bellupon” ka formu edhe “Farmakosin” një pjesë. Komplet antibiotikat, asi paletën e antibiotikave kemi marrë prej Kajfeshit. Ai ka qenë një njeri që i ka ndihmu Kosovës shumë.

Edi Gashi: Na trego pak qysh erdh ideja për me shku në Novi Sad me studiu kiminë. Pse në Novi Sad?

Fadil Softa: Pse në Novi Sad, se kam ditë që asi në Beograd shumë ma ndryshe mentaliteti i njerëzve asht’, shumë ma ndryshe se në Novi Sad. Ma të edukum, ma të sjellshëm janë edhe kam vendosë me shku në Novi Sad.

Edi Gashi: E atje qysh ka qenë në Novi Sad gjatë kohës që keni nejt aty?

Fadil Softa: Shumë mirë kemi kalu, shumë mirë kemi kalu edhe edhe asi njerëzit kanë qenë shumë pozitive për ne, ani që jemi shqiptarë, por ka pasë edhe ato,

Edi Gashi: A ka pasë diskriminime ose...?

Fadil Softa: Ka pasë destruktive, “Pse po vini me studiu këtu?” Edhe qe. Asistenti osht’ i fizikës, njëfarë Jeremiqi ka qenë, a din, “Pse keni ardhë në Novi Sad me studiu? Çka po përzihesh ti në Novi Sad?” “Po Jugosllavia osht’. Pse kam ardhë, kam ardhë”. Edhe mandej lëshum na, 74 vetë kemi qenë. Prej 74 vetëve vetëm dy persona kanë mbet në asi në Novi Sad.

Edi Gashi: Pse? Për çfarë arsye kanë mbet?

Fadil Softa: Po ka qenë në një presion, jo normale ka qenë. Si me thonë, destruktive edhe mendimet e atëhershme kanë qenë. Muj me thonë kështu nacional-shoveniste kanë qenë. Ajo osht’ qajo pengesa për ne.

Edi Gashi: E domethanëm ju nuk mujtët me përfundu deri në fund.

Fadil Softa: Jo, jo, vetëm dy vjet u konë ajo, mandej kimi kam pasë.

Aurela Kadriu: A ka qenë i sapoformum departamenti i kimisë atëherë këtu kur jeni kthy?

Fadil Softa: Po, se ‘71-shin osht’ formu universiteti e dini që ‘71-shi. Unë kam diplomu ‘70-shin, domethanë i pari kam qenë prej gjeneratës së vjetër, mandej, këta gjeneratat tjera kanë qenë në kuadër të Fakultetit të Kosovës, Prishtinës, po.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë jeta si student në Prishtinë?

Fadil Softa: Shumë mirë, shumë mirë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë Prishtina, çfarë qyteti?

Fadil Softa: Prishtina ka qenë jo si sot, por nuk kanë qenë të zhvillim rrugët. Unë si student kam pasë shumë punë, me ato analiza. Jam çu në ora gjashtë, në ora shtatë në laborator. Prej orës shtatë deri në dhjetë në mramje kam punu analizat e kam kry me kohë edhe ai Tihomiri ka qenë shumë... thotë, “Zoti Fadil” thotë, “ju shumë jeni tu punu, mos jeni lodhë?” “Jo”, thashë, “po du me i arritë rezultatet edhe me tregu tjerëve se 34 vetë kemi qenë pesë vetë shqiptarë në atë grupin, po don me tregu që na shqiptarët kemi dijeni dhe dojmë me tregu”. Dhe me të vërtetë me dhetëshe kemi kry. Inati... a po inçizon kjo? A po inçizon? [i drejtohet intervistueses]

Aurela Kadriu: Po.

Fadil Softa: A po, nejtse diçka do të...

Aurela Kadriu: Diçka mujmë me pre nëse doni.

Fadil Softa: Po, nëqoftëse nuk osht’ mirë, nuk ka dalë mirë atëherë bone.

Aurela Kadriu: Nëqoftë se doni ju e prejme na.

Fadil Softa: Jo, jo, kurgjo, (qeshë). Asi edhe kështu kemi kalu me dhetëshe kemi diplomu.

Aurela Kadriu: A keni udhëtu prej Prizrenit për Prishtinë çdo ditë apo keni banu?

Fadil Softa: Jo kam pasë banesën.

Aurela Softa: Ku keni banu, çfarë lagje?

Fadil Softa: Asht’ rruga e Prizrenit. Nuk e di a e dini, se atëherë... ju jeni e re, nuk e dini Prishtinën edhe aq shumë.

Aurela Kadriu: Rruga Prizrenit i bjen te...

Fadil Softa: Ku osht’ asi...

Aurela Kadriu: Nalt.

Fadil Softa: Nalt vjen, nalt vjen edhe aty osht’ rruga e Prizrenit. Nifarë Rrahimi ka qenë emri, ai ka qenë i martum me një serbe, por mirë kemi kalu.

Aurela Kadriu: A ka pasë një ide për me nejt në Prishtinë, me punu a me nejt në Prizren?

Fadil Softa: Jo, jo, kam pasë, dy fëmijë atëherë kam pasë (qeshë). Kam qenë i martum.

Edi Gashi: Domethanë edhe gjatë studimeve sa keni qenë...

Fadil Softa: Edhe studimeve.

Edi Gashi: Edhe gjatë studimeve në Novi Sad keni qenë i martum?

Fadil Softa: Jo, jo masnej, mas Novi Sadit jam martu, dy fëmijë kam pasë e ashtu që kam pasë Rezartën, kam pasë asi Bekimin, kam pasë Rezartën edhe Bekimin. E tash e kam Diellzën i kam Ermirën, Andinin, djalin. Ai osht' me fakultet, e ka kry ekonominë. Tash osht' i angazhum në "Adidas", osht' menaxher i "Adidasit" e kështu.

Aurela Kadriu: E kur u kthytë në Prizren, qysh ndodhi, a shkutë me konkuru për punë në "Farmakos"?

Fadil Softa: Jo, jo. Kam pasë borxhe. Kam pasë, borxhe kam pasë.

Aurela Kadriu: Qysh i bjen?

Edi Gashi: Çfarë lloj borxhi?

Fadil Softa: Kam pasë 35... 3500 dinarë e atëhershëm. Jo, jo, 35 mijë dinarë atëherë. Kam pasë edhe kam pasë kontratë me "Farmakosin", me drejtorin osht' një Dragan Janiqeviq ka qenë drejtor. Ai ka formu "Farmakosin".

Edi Gashi: Domethanë, kjo bursa vike prej "Farmakosit"?

Fadil Softa: Prej "Farmakosit", po. Për kuadra se ky ka qenë shumë progresiv ky drejtori që ka formu "Farmakosin". Ai ka dashtë njerzhtë që asi janë eksperta.

Edi Gashi: Ai e ka formu domethanë "Farmakosin".

Fadil Softa: '63-shit.

Edi Gashi: '63-shit po.

Fadil Softa: Ai osht' para sa viteve, katërdhjetë viteve.

Edi Gashi: A ju ka shku najherë mendja juve gjatë studimeve ose kur jeni kon ma i ri që një ditë keni me punu në "Farmakos"?

Fadil Softa: Jo për besë, jo. Se babai ka qenë në lidhje me babën e Draganit, se atëherë ne kemi pasë kontakt e miqësi kemi pasë. Fare nuk kemi pasë mendime si tanishme që osht' bo. Ashtu që mirë kemi kalu, por sot nuk jemi mirë. Sot nuk jemi mirë, pse? Patjetër duhet me i dhanë randësi kuadrave, sa ma tepër m'i çu jashtë të specializohen, nëqoftëse dojnë me shku përpara. Na nuk jemi tuj mendu, nuk jemi tuj thënë qysh me zhvillu prodhimin, qysh me zhvillu bujqësinë, qysh me... unë jam, unë jam adhures i bujqësisë. Na kemi privat, plantazhën e kam tri hektar, aroni kemi asi... aroni kemi mbjellë, a din çka domethanë aronia? Osht' një ndër prodhimeve që i ka akumulimin shumë ma të lartë.

Po kalojmë tash në temë tjetër, por, jo po tregu kështu asi, po lidhet, vetëm ende asht' aktuale. Për shembull, unë kam bo eksperimentale në shpi, eksperimentale, për katër vjet kam arritë me bo aroni

miranokab, që osht' një ndër aroniave ma kualitative, amerikane osht' por këta thojnë që osht' e rusëve aronia, po... e tash më duket se zotëri Asllani ka, e ka detyrën me kry atë punë edhe...

Edi Gashi: Kush osht' zotëri Asllani?

Fadil Softa: Asllani osht' drejtor i sektorit ekonomik.

Aurela Kadriu: Për mu kthy te "Farmakosi", dashta me ju pyt në çfarë gjendje e keni gjetë "Farmakosin" kur keni shku për herë të parë, qysh ka qenë?

Fadil Softa: Ka qenë mirë.

Aurela Kadriu: Sa punëtorë kanë qenë?

Fadil Softa: Atëherë kanë qenë 160 puntorë. Mandej, ma vonë pas '72-shit asi...o zhvillu 300 punëtorë.

Edi Gashi: Ju keni fillu në '71-tën apo?

Fadil Softa: Po, '70-shin.

Edi Gashi: Ah, '70-shin.

Fadil Softa: Mandej ushtar kam shku.

Edi Gashi: Në çfarë pozite kur keni hy për herë të parë?

Fadil Softa: Kam qenë drejtor i laboratoriumit.

Aurela Kadriu: Çka ka qenë puna që e ke bo në laboratorium, a na përshkrun pak procesin e punës?

Fadil Softa: Shif, në industrinë farmaceutike patjetër duhet me pasë laboratoriumin intern. Pse? Çdo seri që e kemi lëshu, na kemi analizu në laboratorium intern. Domethanë, kualitetin e vitaminës C e fermobabiton ose farmacikrete, kemi lloj-lloj preparatesh. Mandej, atëherë ka qenë Torllaku, Beogradi, Instituti që i ka verifiku kualitetin e këtyre prodhuesve që janë marrë me barnat, kemi çu ekzemplare atje edhe ata kanë bo analizën, na kanë çu ato asi informatën, serinë e kanë dhanë edhe ashtu e kemi lëshu në treg. Asnji seri nuk osht' lëshu pa e analizu. Domethanë, shumë konkrete dhe shumë rreptë kemi qenë, unë posaçërisht, për kualitetin. Se popullin nuk mundesh me helmu, ai provohet najherë nëqoftëse nuk osht' kualiteti i mirë, ashtu që...

Aurela Kadriu: Sa punëtorë i ka pasë ky sektori i laboratoriumit?

Fadil Softa: Shtatë, shtatë i ka pasë.

Aurela Kadriu: Qysh osht' dok nji ditë e juja në laboratorium, çka keni bo?

Fadil Softa: Kështu ka qenë, në mëngjes kur kanë asi planifiku çka me prodhu gjatë ditës, për shembull vitamina C, tekniku ka shku ka marrë mostrën, ekzemplarët domethanë. Ajo ka qenë nga, sa

ka marrë njëzetë copa edhe komplet me farmakopenë², sipas shënimeve të farmakopesë kemi bo analizat edhe kualitetet sipas farmakopesë. Nëqoftëse nuk ka dalë si në farmakope atëherë nuk kemi mujt me lëshu, na kemi qenë rryp [strikt]. Mandej kanë përmirësu, përsëri kemi analizu. Shumë rrallë osht' kanë gabu, se punëtorët kanë qenë shumë të përgatitur për... posaçërisht tekniku. I kam do fotografi unë, do t'ju tregoj juve, por asi nuk e di ku e lashë [fotografinë]. Si drejtor gjithmonë kam qenë prezent në prodhimtari, kështu {tregon foton}.

Aurela Kadriu: Në cilin vit osht' kjo fotografi?

Fadil Softa: Kjo osht', e re osht' kjo. Qe edhe laboratoriumi, unë e kam formu këtë laboratorium prej mjeteve. Qe grupi që kanë punu asi.

Edi Gashi: Në cilat vite këto fotografi janë bo?

Fadil Softa: Këto janë, tash unë kam asi, këto në vitet 2004-shi, 2002-shi, 2002-shi 2004-shi. Këto janë makinat shumë kualitative, prodhimi gjerman "Fette" ka qenë edhe shumë osht' asi i përdorshëm. {Tregom ka fotografitë} Qe edhe këtu kemi, shiheni. Qe si drejtor që kam qenë unë, atëhere. Na kemi bërë së pari pilot seriet, shiheni, pilot seriet, domethanë ai fillimi, mandej serinë e madhe e kemi bo. {Tregom ka fotografitë} Qe këto sendet, qëto fotografi. Qe këtu osht' qysh kemi punu asi edhe kemi caktu sa killopond osht' ajo forcë e tabletës, se nëqoftëse osht' shumë e fortë, nëqoftëse osht' shtatë killopond, për shembull nuk tretet në lukth.

Aurela Kadriu: Me matë a?

Fadil Softa: Po, me matë fortësinë.

Aurela Kadriu: A ka pasë naj lloj të barit autentik që e keni prodhu në "Farmakos" apo vetëm qato?

Fadil Softa: Jo, vetëm vitamina C ka qenë autentik. Po krejt prej programit të prodhimeve tjera me firmat gjermane, nonfirma gjermane, domethanë licensën kam marrë si osht' viromerci patentik, si... mandej, Nitromaku. Krejt janë këto të licencume asi... ato preparatet që kemi pasë licencën së pari kanë lëshu pillot serien gjermane, domethanë ekspertët gjermanë. Mandej kur kanë kry analiza osht' bo. Mandej njerëzit tonë kanë bo serinë tjetër edhe atë seri kur osht' kry, për shembull asi puna, ekzemplarët janë çu në Gjermani. Atje e kanë bo analizën, mandej gjithmonë kemi vazhdu.

Edi Gashi: Janë kthy mandej.

Fadil Softa: Jo, kemi vazhdu mandej ata nuk kanë qenë asi i interesum me çu se kemi qenë i përgatitun na, e kështu.

² Pharmacopoea, në kuptimin e saj modern teknik, është një libër që përmban udhëzime për identifikimin e ilaçeve të përbërë.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: A po na tregon pak, a ka pasë eksport të barnave? Sa ka qenë eksporti dhe në cilat vende keni eksportu?

Fadil Softa: Po, qysh jo, ma s'paku e kemi realizu në Kosovë asnji përqind mallra, ju kemi shitë një përqind. Në asi Republikat e ish-Jugosllavisë kemi çu në Serbi, kemi shitë 70 përqind për shembull, mandej në Kroaci kemi shitë. Eksportin kemi pasë edhe në Bashkimin Sovjetik, Patentexin e kemi çu. Ai osht' një preparat, i vetmi fabrikë që ka prodhu atëherë prej 114 fabrikave në ish-Jugosllavi. Na kemi pasë prodhimin specifik, çka do të thotë? Na nuk kemi hy në paralelizëm, a e dini çka osht' paralelizëm? Preparatin njejtë me prodhu, për shembull Fenobarbitona, nuk kemi prodhu na ato, por kemi hy në specialitetet, kemi regjistru, kemi mbrojt patentin edhe kemi lëshu në treg edhe shumë interesant ka qenë.

Ne Patentexin kemi eksportu për Poloni, për Çeki, për... Sllovenia ka marrë ashtu ashtu, por me nantë firma gjermane kemi punu. Edhe kemi qenë të suksesshëm shumë, kualiteti ka qenë i lartë. Për shembull, Nitromaku, asnji fabrikë nuk ka prodhu prej 14 fabrikave. Mandej osht' Hidrofilina po ashtu. Rekavani, Rekavani osht' substancë reaktive kalium-klorid, vetëm na e kemi pasë kaliumin, mungesë e kaliumit në organizëm për shembull. Po mendoj, preparati ka qenë shumë i nevojshëm asi atëherë, por edhe sot nevojitet kaliumi ashtu. Viromerci për herpeset, për shembull prej mercit kemi pasë Viromercin për herpeset, zosterop, herpes genital, herpes simpleksik e këto sene. Domethanë, specifike, një pjesë dërrmuese e preparateve e kemi pasë, vetëm "Farmakosi" ka prodhu.

Aurela Kadriu: A ka pasë sindikatë të punëtorëve "Farmakosi"?

Fadil Softa: Ka, ka pasë. Na kemi pasë sindikatën, ashtu, ashtu.

Edi Gashi: Sindikata e përgjithshme ka qenë.

Fadil Softa: Eh ashtu, sindikata ka ekzistru, por ata kanë qenë prej punëtorëve të zgjedhun, por kurrë asnjëri problem nuk kemi pasë, se gjithmonë rrogat kanë qenë në rregull. Gjithmonë tepricat kanë qenë, gjithmonë shumë ma tepër kemi rujt interesin e punëtorëve. Ashtu që, nuk kemi pasë problem kurrë.

Aurela Kadriu: Çka ka ndodhë që keni mbërri m'i dhonë deri 17 rroga punëtorëve.

Fadil Softa: Po, ashtu.

Aurela Kadriu: Qysh ka ndodhë kjo?

Fadil Softa: Po, na nuk kemi guxu me dhonë 17, dymdhetë jonë, por kemi dhënë nëpërmjet ndihmës, jo dru, jo këto sendet, se nuk ka guxu. Ky shefi i financave nuk ka guxu me tregu zyrtarisht, a din, që po i japim, por pak ma ndryshe. Domethanë, eskivazha kemi bo a, eskivazha. Kështu që, kemi dhanë, punëtorë kanë qenë të kënaqun.

Aurela Kadriu: Qysh ndodhi në vitin '92 që u largut prej "Farmakosit"?

Fadil Softa: Eh, '92-shi osht'... se nuk kam pranë, nuk kam pranë atë deklaratën me nënshkru, po mendoj kështu duhet me tregu. '92-shi osht' pak ma larg.

Edi Gashi: Pak ma larg, veç dashta me ditë, qysh jeni bo drejtor i prodhimit? Në cilin vit? Varësisht që keni qenë...

Fadil Softa: Histori e madhe osht' ajo, histori e madhe se asi byrokracia politikane kanë qenë, shumë presion kanë pasë. "Farmakosi" ka qenë një ndër firmat shumë variantabile, çdokush ka dashtë me bo drejtor, ka lyp m'u bo drejtor.

Edi Gashi: E për atë arsye, qysh erdhë puna deri aty apo?

Fadil Softa: E deshta me tregu këtë largimin prej atë politikën serbe që ka qenë.

Edi Gashi: Po vimë prapë, po shkojmë kronologjikisht, ndoshta ma mirë kish me qenë.

Fadil Softa: Po, qe, qe, qe, për shembull deklarata osht' dashtë me nënshkru që duhet me pranë Serbijën, se me Ibrahim Rugovën na kemi qenë. Nji parti kemi pasë edhe shumë kemi dashtë atë parti, posaçërisht Ibrahimin. Kemi luftu për interesat e popullit, nuk kemi luftu për interesat personale. Shihe edhe na t'kishim me pasë interesin me gjithë punë, kurrë nuk kemi asi leju vetës, asi me bo këto sendet.

28 vetë nuk kanë nënshkru deklaratën edhe zavendësi im ka qenë nifarë Furjanoviçi që nuk kam pranë une deklaratën me nënshkru. Thotë, "Edhe ti Fadil nuk po don me nënshkru a?" "Jo", thashë, "ku osht' populli im atje shkoj. Ama", thashë, "atë vendimin për largimin". E nënshkrupa, e mora, dola. Kurrë nuk jam kthy mo deri '99-shin. Prej '92, domethanë shtatë vjet kam qenë pa punë, shtatë vjet, por kam punu kështu privatisht. Kam pasë prodhimet e mia, kam prodhu.

Edi Gashi: Çka kanë qenë benefitet e Prizrenit si qytet, ekonomike po flas prej "Farmakosit", domethanë prej viteve të '70-ta prej kur keni qenë ju deri '92?

Fadil Softa: Benefite për kend? Benefite për kend?

Edi Gashi: Prizrenin, si Prizren, si qytet.

Fadil Softa: Po Prizreni si qytet, Prizreni ka qenë i furnizum me barnat ma tepër, se na direkt nuk kemi pasë drejt me dhanë barnatoreve, nëpërmjet veledrogerijave³, ata që merren me shumicë, kemi pasë drejtë me shitë atyne, jo asi. Por, na kemi bo digresion. Digresion kemi bo për arsye se kemi dhonë për shembull Xhemalit, nji ndër barnat të farmacisë, veç që kemi, direkt kemi dhanë se ai ka ndihmu njerzëve shumë, ashtu që nuk kemi pasë frikë. Kërkush nuk ka marrë vesh që jemi tu i dhënë direkt asi [barnat].

³ Kompani që merren me importin dhe regjistrimin e produkteve të reja mjekësore, deponimin, shitjen dhe shpërndarjen e ilaçeve dhe pajisjeve mjekësore.

Edi Gashi: E punëtorët në përgjithësi në “Farmakos”, a kanë qenë shumica të Prizrenit?

Fadil Softa: Të Prizrenit janë krejt edhe rrethinë.

Edi Gashi: Shqiptarë, boshnjakë, serbë?

Fadil Softa: Shqiptarë, boshnjakë, ka qenë lloj-lloj domethanë një konglomerat asi njerëz. Ashtu që kurrë nuk kemi pasë, nga aspekti nacional a din, kemi qenë bashkë edhe serbi edhe myslimani edhe turku ka qenë, edhe turq kemi pasë edhe kështu. Ne jemi faktikisht të orientum te internacionalet, se drejtor kur kam ardhë ‘88-shit, se vdiq, do t’ju tregoj fotografinë, Janiqeviq. Ai vdiq ‘80-shin, ai ka pasë kancer në tru. Në Beograd s’kanë mujt me me asi [shpëtu]. Ai ka qenë farmacist. Mandej, në vend të atij ka ardhë Abdullah Shukriu, nuk e di a keni ni, axha i Edit Shukriut. Domethanë, Edi Shukriu osht’ asi, Edi Shukriu osht’ çika dajës tem, Muhametin edhe Abdullahin dajë e kam pasë. E osht’ martu me këtë Ukshinin. Ai e ka shkru një libër, sot duhet mu interesu për atë librin. Kosova, “Antika e Kosovës” asi e ka shkru, nuk e di a e keni pasë rastin me...

Aurela Kadriu: Po, po, po.

Fadil Softa: Edhe aty shifet qysh kanë vjedh serbët asi eksponante prej Kosovës, për shembull vrapusin kanë vjedhë.

Edi Gashi: Vrapusja Prizrenit.

Fadil Softa: Vrapusja e Prizrenit, po. Ka shumë asi.

Aurela Kadriu: Qysh erdh situata që ju u bonët drejtor i prodhimit?

Fadil Softa: Unë a?

Aurela Kadriu: Po.

Fadil Softa: Jo, gjeneral, drejtor gjeneral. Kam qenë drejtor i laboratoriumit, mandej drejtori gjeneral.

Aurela Kadriu: E qysh ndodhi që ju mu bo?

Fadil Softa: Shumë keq, nuk kam dëgju politikën. Nuk kam dëgju politikën.

Aurela Kadriu: A nuk ishte kjo njifarë prioriteti?

Fadil Softa: Osht’ dashtë... Shife, atëherë, nuk e dini, ju sigurisht nuk jeni të informum asi... se atëherë ka qenë trupi koordinus në kuadër të qytetit, kryetari ka qenë i Lidhjes Socialiste, ka pasë, kryetari asi, por osht’ dashtë me pytë komisionin koordinues për me konkuru. Domethanë, ti duhesh me pytë dikend për me konkuru. Unë nuk kam bo ato.

Edi Gashi: Edhe ju konkurut?

Fadil Softa: Edhe unë konkurova. Pse? Tash nëqoftëse mundet dikush jashta asi “Farmakosit” me ardhë që nuk ka lidhje me farmaci, unë kam drejt se kam punu shumë vite edhe e di punën shumë mirë, pse mos me kenë edhe unë drejtor.

Edi Gashi: Edhe nuk haset në probleme?

Fadil Softa: Jo, kom hasë.

Edi Gashi: Apo a?

Fadil Softa: Po, po jam hasë në probleme. Më kanë thirrë në Komitet. “Qysh ti mundesh me bo asi, me konkuru kur duhesh me pyt komisionin?” “Pse”, thashë, “me pyt? Për çfarë arsye? Tregomni ju për çfarë arsye? A kam të drejtë si anëtar i fabrikës me konkuru?” Edhe heshtën, heshtën edhe kanë bo kështu në këtë drejtim, kanë bo, kanë bo presion Sekretarit. Nifarë Bahria Skenderi ka qenë për me anulë konkursin, kanë anulë konkursin. Mandej, pas 20 ditëve përsëri kanë hapë konkursin. Përsëri konkurova.

Edi Gashi: E a kish që konkurojshin shumë tjerë?

Fadil Softa: Jo, s’kanë guxu. Jo, jo, ata guximtarë që kanë qenë kanë konkuru. Jo, jo, edhe s’kanë pasë ku me shku, kanë pranë mandej.

Edi Gashi: Në cilin vit ka qenë kjo?

Fadil Softa: ‘88-shi.

Edi Gashi: ‘88?

Fadil Softa: Po.

Edi Gashi: Domethanë, ‘88 deri ‘92, katër vjet mandej si gjeneral.

Fadil Softa: Jam largu. Mandej si drejtor gjeneral, jam largu për shkak të politikës a din? Mandej ‘99-shin erdhën përsëri, i hapën dyrtë. Bile, bile në Londër paska pa motra ime t’u u hapë asi dyrtë kemi depërtu edhe kemi shkru lajmin që çdokush, çdo anëtarë i fabrikës pa marrë parasysh në kombësi, ka të drejtë përsëri me u kthy në “Farmakos”. 125 vetë janë kthy. Krejt shqiptarë kanë qenë, po serbët kanë lëshu Prizrenin edhe e kemi lanë konkursin, asi, lajmin, lajmin kemi lanë. Kemi lanë bukur gjatë.

Edi Gashi: Qysh i keni gjetë makineritë e prodhimit, a kanë qenë, a kanë qenë në gjendje...?

Fadil Softa: Patën asi, patën largu maqinat, por kemi gjetë nëpërmjet KFOR-it.

Edi Gashi: Apo?

Fadil Softa: Po i kemi gjetë.

Edi Gashi: E a ka funksionu prej '92-tës, po mendoj prej '92-tës masi që punëtortë shqiptarë që e kanë lonë punën aty, a kanë funksionu "Farmakosi" me punëtorë serbë?

Fadil Softa: S'kanë mujt me funksionu. Pak, pak, shumë pak kanë funksionu.

Edi Gashi: Sa përafërsisht?

Fadil Softa: Për besë, një vjet ose dy vjet kanë funksionu. Nuk kanë pasë asi kuadrat, pa kuadrat nuk mundësh ti asi... me zhvillu farmacinë, se farmacia nuk duron. Në farmaci nuk guxon me gabu, se nuk mundet çdo kush me punu në këtë drejtim vetëm ekspertët. Unë kam qenë një ndër ekspertëve që kam me kokëfortësi, a din, edhe me të vërtetë. Por, për të drejtën, kokëfortë jam për të drejtën. Kurrë asnji, asnji punëtorë, nuk ka pasë problem me drejtorin, gjithmonë një konsensus kemi pasë, një marrëveshje me këta edhe kështu.

Edi Gashi: E gjatë luftës, ku keni qenë ju, a keni qenë në Prizren?

Fadil Softa: Në Prizren kam qenë 77 ditë, 77 ditë po. Tre muj ditë, tre muj ditë edhe kam qenë në asi, domethanë m'kanë lyp, serbët m'kanë lyp.

Edi Gashi: A po? A ka pasë përndjekje?

Fadil Softa: Jam mshef asi nëpër mik, miq, nëpër asi.

Edi Gashi: Domethanë edhe gjatë luftës këtu keni qenë?

Fadil Softa: Këtu kam qenë në Prizren.

Edi Gashi: A keni punu gjatë asaj kohe diçka apo?

Fadil Softa: Nuk kam punu, po kemi pasë mjetet për jetë. Kumeditë sa, jo. Vetëm kemi përballu atë periudhë, kemi përballu.

Aurela Kadriu: Kur u kthyt pas luftës në "Farmakos", a erdhën edhe serbët?

Fadil Softa: Jo, serbët nuk kanë ardhë. Edhe një send po du m'i ju tregu. Kur jemi kthy krejt dokumentacionin që kam lanë une aty, se dokumentat, shumë dokumenta kemi pasë atje. Ende nashta nëqoftëse ky nuk ka prish, ky që ka ble. Kur jemi kthy ata nuk kanë prek literaturë fare, serbët.

Edi Gashi: Domethanë, nuk osht' prekë kurgjo në objekt.

Fadil Softa: Realitetin duhet me tregu. Shif, nëqoftëse ju them diçka tjetër gaboj edhe krejt ato sendet por tonët çka kanë bo, literature çirilicë e kanë çky, tonët kur kanë hi, shqiptarë. "Pse?" Thashë, "Për çfarë arsye literaturën?" "Po, serbisht". "Po ani, a kemi na literature për asi, për farmaci?" "Jo". Ata kanë pasë literaturë edhe na kemi marrë prej asaj literaturës kemi mësu asi farmaci, qysh? Edhe e mbledha krejt edhe ato edhe kam bo një bibliotekë edhe çdokush që vike ma vonë përdorke. Bile, bile edhe disa

persona prej podrumit kanë ardhë te na me bo analizat e Vinjakut edhe i ndjeri Hyseni. Hysenin e kanë vra e din ti, Hysenin, sërbët kanë vra ato, se ai ka pasë formulacion, formulën e Vinjakut.

Aurela Kadriu: Çka osht' vinjaku?

Fadil Softa: Vinjaku osht' raki. Raki osht'. Ai ka pasë formulën edhe asi për fat të keq.

Aurela Kadriu: E mbas luftës, qysh?

Fadil Softa: Jo, jo, pas, pasi që asi, se pas luftës mandej ka qenë një periudhë që serbët kanë qenë këtu, ata kanë vra. Ata kanë vra edhe e kanë gjetë me një vend, kumeditë.

Aurela Kadriu: A vazhdu me punu mas luftës në "Farmakos", a patë punë?

Fadil Softa: Kush?

Aurela Kadriu: Ju?

Fadil Softa: Po, po, pas luftës po.

Aurela Kadriu: Deri kur?

Fadil Softa: Deri te privatizimi.

Aurela Kadriu: E qysh ndodhi ky privatizimi? A po doni me folë për këtë pjesë, çka ka ndodh?

Fadil Softa: (qeshë).

Aurela Kadriu: Mundeni mos me folë nëse doni.

Fadil Softa: Jo, jo, mundemi, po duhet me kritiku njerëz, po nuk po du me emna me asi.

Aurela Kadriu: S'ka problem.

Fadil Softa: Nuk po du për arsye se... së pari asi institucioni shtetëror kanë gabu çështjen e privatizimit, pse? Musa Alibani ka qenë një ndër prej personave i asi, konsideroj shumë se është për makro për mikroekonomi profesor doktor osht' edhe kam punu, ai ka qenë drejtor i Institutin për Ekonomi, drejtori ekonomik, Institutit Ekonomik në kuadër të Fakultetit Ekonomik edhe unë kam bashkpunu. Krejt programet kemi shku nëpërmjet Institutit Ekonomik edhe shumë korrekt ka qenë Musa Alibani. Ai osht' gjallë sot.

Edi Gashi: Po për cilat vite jeni t'u folë tash?

Fadil Softa: Kjo osht' unë kur bleva "Farmakosin", se unë bleva niherë.

Aurela Kadriu: 2004 a?

Fadil Softa: 2003-2004.

Edi Gashi: 2003. Domethanë mas luftës masi që u kthyt në “Farmakos”?

Fadil Softa: Unë mora 800 mijë euro kredi me Bankën Private të Biznesit, Nazim Mustafa ka qenë drejtor edhe Bujar Spahiu nuk e di a keni ndi emrin a jo. Po kam gabu.

Edi Gashi: Për çfarë arsye?

Fadil Softa: Për arsye se interesi i Bankës Ekonomike ka qenë në emër të “Farmakosit” me marrë kredi prej Bankës Ndërkombëtare, me pshtu bankën. Po, se ai ka qenë minus dhetë milionë euro. Njizetë milionë me marrë prej Bankës Ndërkombëtare me shpëtu bankën jo “Farmakosin”. Ai shkaktari ka qenë, domethanë politika destruktive, nuk e kam pa, atëherë kam shitë aksionet edhe grupin e Prizrenit që kanë qenë për prodhimtari, kam tërhjekë edhe kam tregu që mo nuk jemi na aty edhe krejt qat pjesën që e keni, ju keni me pasë edhe jam largu prej asaj, prej “Farmakosit”.

Aurela Kadriu: Nji pyetje, sa ka pasë prodhim përpara “Farmakosi” për afërsisht?

Fadil Softa: Po qysh po mendoni, numerikisht a?

Aurela Kadriu: Me euro?

Fadil Softa: Me euro...

Aurela Kadriu: Se po du me bo krahasimin sa osht’ shitë edhe sa ka pasë kapacitete.

Fadil Softa: Po shife tash atëherë kumedit me thanë nji milion euro, nashta nji million euro ka pasë.

Aurela Kadriu: E sa osht’ shitë mandej në privatizim?

Fadil Softa: Privatizim, po mendon asi, “Farmakosi”?

Aurela Kadriu: “Farmakosi”.

Fadil Softa: Dy milionë e 300 mijë, dy milionë e 300 mijë. Por kam gabu une atëherë. Nuk kam ditë që mundet të jetë ashtu nji politikë destruktive, e me tylifare dallavere edhe kam shitë aksionet. Kam pshtu njerëz edhe veten kam pshtu e tash jom...

Edi Gashi: E domethonë prej 2004 mo nuk funksionon.

Fadil Softa: Jo, qysh mundet me funksionu? Si e pate emrin, Edi?

Edi Gashi: Edi.

Fadil Softa: Qysh mundet me funksionu pa ekspertë, qysh? Me tregtarë nuk bohet ajo. Ata janë krejt tregtarë, me Nazmi Mustafën, me Bashkim Kastratin, me... Ata nuk kanë qenë interesum me zhvillu “Farmakosin”, domethanë me rritë programin, me rritë numrin e preparateve, me gjetë asi partnerë tjerë, asi për me fut preparate tjera por nji prej preparateve kur kam fut në prodhimtari, pas katër

viteve kam pasë rezultat. Domethanë, osht' dashtë me prit katër vjet, me propagu, me bo që me pasë akumulim.

E këto janë sendet që, mos më kuptoni keq, shiptari, shiptarit pak bon problem, kur kam shku në "TreFarma", ekziston "TreFarma", e dini? E di te Mërgimi, eh ashtu m'i ja ofru dijeninë, m'i ja ofru programet, m'i ja ofru asi specialitetet që kemi pasë na, po kishte me ndigju ai mu atëherë, a din, se Musa Limani osht' ilake [kushëri] me, se me Musa Alimanin kemi shku te ai. Baba qysh e ka pasë emrin, i Mërgimit? Prishtina osht' apo?

Aurela Kadriu: Prishtina jo, po...

Fadil Softa: Bedri Prishtina, kanë ndërru emrat për shkak asi problemeve, e dini sigurisht edhe nuk ka asi pranu ashtu që... edhe niherë shkova mandej me do eksperta prej Beogradit me bashkëpunu asi, nuk ka asi pranu, por o fut në prodhimtari, në atë sistemin paralele, domethanë ka prodhu ampicilinë, si ata tjerët, por nuk ka tregu vet, tash i ka probleme. Na kishim me bo atë firmën se shumë mirë ka pregaditë, teknologjia e përsosur osht'.

Megjithëse mbi kushtet, ai e ka fut shumë para asi në këtë fabrikë, por nuk ka pasë njerëz. Shumë para ka dhonë tjerëve amerikanëve edhe prej Indisë kanë qenë, shumë para ka dhonë. Me ato para kishim me bo shumë sende. Na kemi patente tjera, për shembull për shërimin e majasilit, për shërimin e prostatës, krejt këto sendet kemi prej bimëve mjekësore, se une mirrna me asi me medicina alternative tash asi, tash e kam punën me Turqi.

Pardje çova 50 ekzemplarë, që ta shikojnë, le ta provojnë asi, edhe tash do të asi bashkëpunoj me ta edhe kontratë do ta bëj, do të shkoj anena. Çka me bo këtu në Kosovë, kur atë dijenin që kam 30 vjeçare nuk muj dikujt me, ty me lan. Shkova në Shipëri, e interesant osht' me Shipërinë qysh kemi, se kur kemi, a muj me tregu këto?

Aurela Kadriu: Po, po, po qysh dush.

Fadil Softa: Interesant osht', se '99-shit kur kemi fillu prodhimin atëherë osht' dashtë instituti me bo analizat e seriave që osht' problem me bo. Na nuk kemi pasë në Kosovë s'ka, qendër kombëtare për kontrollimin e barnave s'ka.

Edi Gashi: Po ka qenë në Beograd veç.

Fadil Softa: Beogradi ka qenë, nuk kemi guxu atje me shku. Sarajeva larg, Istambulli larg. Mandej vendosa, hypëm në aeroplan, në ballon hypëm, shkum në asi, në Tiranë, se Tirana ka pasë institutin për kontrollimin e barnave që osht' pranu në Evropë asi. Edhe hynëm mrena. Ilir Miga, drejtor i asi [Instituti] ka qenë. "Urdhnoni, zotëri", tregova kush jam, tek jam drejtor i "Farmakosit", kemi probleme kështu, kështu, kështu që patjetër duhet një institut me bo analizat e prodhimeve që asi prodhojmë. "Po ani çfarë probleme?" Thashë, "Më duhet një kontratë te ju me bo analizat". Tha, "Zotëri Fadil", tha, "shumë lehtë".

“Qysh, qysh?” Thirri sekretareshën, si sot e mbaj n’mend, sekretareshën, [me shkru] asi marrëveshjen e mirëkuptimit, qendra kombëtare për asi, për hulumtimin, asi Qendra Kombëtare e Analizimit të Barnave të Shqipërisë me “Farmakosin”, mirëkuptimin edhe kemi bo. Kam çu ekzemplarët, me kombi i çojsha unë këto ekzemplaret, ata bojshin analizat, kthejshin. Nji ditë, dy ditë, tre ditë, nji javë, nji muj, nji vjet [kaloi]. Kur kaloi nji vjet thashë, “Asnji dinarë nuk kemi pagu na, asnji fening nuk kemi pagu”. Se ato janë shpenzime të mdhaja, se ato kemikalja standarde që duhet me pagu ato sendet edhe unë i hypa ballonit, sërish shkova atje.

Kur shkova, tha, “Çka ki Fadil?” Tha. “Vallahi”, thashë “për Zotin kështu, se kështu nuk bohet”. “Qysh po mendon?” “Paj, na kurgjo s’kemi pagu deri tash. Ato janë harxhimet e juja, në të vërtetë na për veti kemi bo, por harxhimet janë ndalë. Ju jeni varfur, po edhe na jemi varfur, por duhet ato harxhimet të bahen, ato shpenzimet me pagu”. “S’bon Fadil”, “Jo”, thashë “prej këtuhit nuk do të çona pa e bo kontratën tjetër”. Bon, s’bon, s’bon edhe e binda. Hajde po shkojmë në ministri për, Ministrinë e Shëndetësisë në kuadër të Kuvendit të Andrea Mateu, drejtori ka qenë. Ai një njeri xhentëllmen, si me thonë, “Çka erdhët?” Tha, emrin Ilir, “Valla une s’do të tregoj, tregojë ti pse je ardhë”.

“Çfarë problemi ka?” “Po”, Thashë, “duhet kotrata për me dhonë, në atë kontratë duhet me e parapa shpenzimet e krejt ato sendet. Kur bohen analizat, paguhen, shumë lehtë”. Edhe ai e thirri sekretareshën, kontratën aty për aty e ka bo. Kemi nënshkru kontratën, na tri vjet deri te privatizimi na kemi punu edhe kemi pasë shumë, shumë pozitive analizat. Ka qenë Rilinda Klosi, nji eksperte rangut evropiane që ka ditë punën shumë mirë, eksperte ka qenë. Kemi punu tri vjet, kemi pagu. Ata çojshin asi me letër, na konvertojshim. Nëpërmjet bankës çojshim direkt edhe shumë mirë kemi punu. E tash qysh me punu, qysh me ndihmu tash Rilindës? Po ajo ka qenë eksperte që ka ardhë te na, ka bo bisedë edhe me ekspertet tona kanë bisedu, kanë ndihmu shumë.

Edi Gashi: E kjo ka qenë e periudhës ‘99, 2003-4 a?

Fadil Softa: Qashtu, qat periudhë. Kjo osht’, që po foli 2002-2003 osht’. Thashë, “Rilinda”, thashë, “ti, osht’ Simpoziumi i Farmacisë i Evropës në Opati, ti do të shkon atje?” “Qysh zoti Fadil?” “Të lutem, osht’ sigurum krejt, osht’ pagum për nji javë ditë shpenzimet. Çka ki pasë krejt në emër të ‘Farmakosit’”. “Nuk osht’ [e nevojshme]”, “Të lutem”, thashë, “patjetër duhesh me shku”. Edhe shkoi, dëgjojt, shkoi. Ka kalu aq mirë, kanë bo seriat aq mirë. Kur erdhi, çka me thonë, “Zoti Fadil, pse e bonët këto?” “Po ju keni bo shumë t’mira për kuadrat tona, qysh mos me e bo juve, qysh mos me e kthy?” Tash me i dhonë para, thojnë korrupcion osht’. Po kështu ma mirë edhe e keni pa Opatijen edhe jeni njoftu me njerëz të Evropës”. “Po”, tha. Edhe qeshtu kemi bo e këto janë sendet.

Edi Gashi: Kisha dashtë me u kthy edhe niherë te vitet ‘90-ta, a ka pasë krizë të barnave masi që... për shembull, masi që osht’ largu kuadri, shiptartë prej “Farmakosit”? A ka ndiku qysh ka ndiku?

Fadil Softa: Ka pasë, ka pasë. Ka pasë, për shembull na... po, po, ka paës, por nuk kemi mujt me punu gjatë luftës shumë, a din, se kontroll ka qenë asi nuk kanë leju. Për shembull, Fenobarbitoni harxhohet ku ka luftë. Na kemi pasë në program Fenobarbitonin edhe shumë kemi shitë atëhere. Blejshin këta tregtarë, Fenobarbitonin blejshin. Ku kanë çu nuk e di. Problem ka qenë, ka qenë problem.

Edi Gashi: Qysh u bojke furnizimi?

Fadil Softa: Furnizimi msheftas ka qenë. Detyrum kemi qenë, vetëm kaloi ajo periudha ashtu.

Aurela Kadriu: A keni pasë rezerva mandej, për me furnizu UÇK-në gjatë luftës?

Fadil Softa: Kemi pasë një pjesë rezervë edhe UÇK-së kemi ndihmu, shumë kemi ndihmu UÇK-së. Unë posaçërisht, ky si e patë emrin, ky komandanti që e ka ftyrën pak asi, ai, pak damtum, osht' anëtar i kuvendit, osht' anëtar i kuvendit osht'. Lekaj apo si? Ai ka qenë komandant këtu në Nashec ka qenë, në Nashec ka qenë. Edhe shumë kemi ndihmu me prodhimet tona, posaçërisht me prodhimet të mija private. Nëpërmjet barnatores kam dhonë, kurfarë para s'kam lyp hiç edhe qeshtu kemi kalu.

Edi Gashi: A i prishët raportet, a ju hupën raportet me kolegtë serbë, t'themi asaj kohe, apo?

Fadil Softa: Vërtetë, në të vërtetë po, nuk kemi pasë mo afërsi.

Edi Gashi: S'keni qenë kolegë.

Fadil Softa: Kolegë kemi qenë, por po.

Edi Gashi: Keni qenë drejtor.

Fadil Softa: Po ata kanë bo një send, se tash asi qysh me thon, thojnë që kanë gabu, por ka kalu ajo periudhë, nuk kthehet mo. Nuk osht' ajo afërsia e dikurshme, se ndryshe mendon ai, qysh po dëgjojmë, nëpërmjet "TV Pinkut"⁴ nëpër këto sene ata jonë ende... thashë nuk po du politikë, por apet politikisht po lidhemi, edhe ende janë asi kundër shiptarëve, ende. Shumë ma mirë kishte me qenë m'u kthy asi qysh kemi përgaditë, për shembull atëherë ekzemplaret, krejt prodhimet tona kanë qenë, kështu krejt në këtë mënyrë t'prezantume. A pe sheh?

Edi Gashi: Këto na mundemi mandej m'i marr, me i fotografu.

Fadil Gashi: Shifeni me i fotografu këto asi...

Aurela Kadriu: Faleminderit shumë zoti Fadil.

Fadil Softa: A kemi kry apo duhet hala diçka?

Aurela Kadriu: A keni diçka me shtu ose Edi a ka ndonji pyetje? Nëse doni a keni diçka me shtu?

Fadil Softa: Jo, une po du me shtu asi... qysh me zhvillu asi industrinë farmaceutike në Kosovë edhe në çfarë mënyrë duhet ta [mbajmë]. Duhet vetëm me përgaditë kuadrat e mira që kanë eksperiencë të asi zhvillon, personalisht çdokush sa e din, a din, nuk e di unë, për shembull "TreFarma", kritikoj "TreFarmën" edhe Mërgimin pse nuk po bashkëpunon me ne, pse nuk po, bile bile një miqësi, një bisedë me bo, me tregu Mërgimit se ai osht' ekonomist, ai ka farmaci. Kur shkova une me tregu me

⁴ Pink Tv, është televizion privat në Serbi.

babën e vet edhe baba i vet, pytke asi investimet, kanë investu shumë për afërsisht, dhetë milionë euro kanë investu.

Tha, “Për sa muj me kthy ato paratë? Sa vjet?” Thashë, “Zotri Bedri”, thashë, “shumë keq, tash qysh me dhonë përgjegjje, por unë muj me thonë për shembull, une, qysh une kam punu, a kam investu në një asi preparat. Neve ka pasë nevojë, tregova parëz, ka pasë nevojë katër vjet me prit, për me pasë rezultatet”. “Ouuu”, tha, “une muj me prit edhe dhjetë vjet”. Domethanë, ka para. E tash sendi tjetër, une s’po shoh nëpërmjet institucionet, nëpërmjet këto komisionet, a çka po di kush osht’ i angazhum asi për zhvillimin e ekonomisë të Kosovës, a din.

Esenca osht’ me zhvillu industrinë farmaceutike se osht’ një industri specifike që don kuadra të mira, shumë kohë duhet me kalu, se barnatoret nuk janë t’interesum në farmaci për prodhimtari, ata janë tregtarë, si banana me shitë, ashtu. Sigurisht nëqoftëse kjo shkon nëpërmjet mediave atëherë thojnë ky po kritikon. Nuk po kritikoj, po qashtu osht’. Prodhimi don njerëz serioz, don që janë pakorruptum. Nëqoftëse korruptohet aty, atëherë nuk ka sukses. Unë jam kundër korruptionit, kurrë nuk kam bo asisoji, asi marrëdhanye me dikend. Qe me Turqit sot muj mi ju tregu juve, me ju thonë qysh kam vepru.

Qe do t’ju tregoj, {inxjerr çantën} m’duket që atë ditë kam tregu a? Kam tregu, për qato. Këtu Irfani ka qenë, ka qenë nifarë zotëri Irfani ka qenë, “Sa osht’”, tha “sa osht’ përqindja ime këtu?” Thashë, “Tregom ti, sa po lyp?” Tha, “30 përqind”. Domethanë, investimet e atij, dijenia jonë. “Jo”, Thashë, “s’bon!” “Pse, zotri Fadil?” Thashë, “Unë punoj 50-50, 50 përqind, pse? Nëqoftëse shkojmë në këtë mënyrë qysh po propozoni ju, atëherë nuk osht’ reale, bohet probleme. 50 përqind atëherë ka sinqeritet aty, nuk mundet të gabohet”. A din çka tha? Tha, “Herën e parë në jetën tem, unë punoj me gjermanë, kurrkund nuk osht propozu 50 përqind”. Qat mendimi kam, nëqoftëse dojmë me bashkëpunu një kohë të gjatë osht’ qishtu.

Aurela Kadriu: Faleminderit shumë, zotëri Fadil.

Fadil Softa: Të lutem.